

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda, duke vendosur sipas Kryatares së trupit gjykues Emine Salihu dhe anetarve te trupit gjykues Luljetë Shabani dhe Afrim Shala, me pjesmarrjen e sekretares juridike Fatmire Sermaxhaj, ne çeshtjen penale të akuzuarve: H. A. nga Gj, F. H nga fsh. S. e P dhe T. N nga fsh.Zh, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.280/14 prej 22.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt. 26.10.2015 , shqyrtimit të dytë më dt. 22.02.2016, dhe pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, oral dhe publik më dt.05.04, 20.05, 29.07, 19.10, 20.12.2016, që më datë 21.12.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit – Departamenti për krime të rënda Afrim Shefkiu, të akuzuarve si dhe mbrojtësve e tyre av. Dr.sc.M. M, R. S , muar dhe publikisht të njëjtën ditë shpalli këtë

A K T G J Y K I M

E akuzuara Hi. A pa pseudonim dhe emër të rrejshëm nga i ati S dhe e ëma Fe e lindur S e lindur më dt., në fsh. K, jeton në, ka të kryer fakultetin Juridik, me profesion Juriste – zyrtare ligjore në Drejtorinë për Kadastër pronë dhe gjeodezi në Komunën e Vitisë, e martuar pa fëmijë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e R. të Kosovës, më parë e pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë edhe për vepër tjetër penale.

I akuzuari F. H, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm nga i ati Xh dhe e ëma F e lindur Sh, i lindur më dt..., në fsh. S. e Pe, K. e Vë, ku edhe jeton, ka të kryer fakultetit juridik, me profesion Jurist i Diplomuar, shef në sektorin e K,. pranë Drejtorisë për V i martuar – baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, kinse më parë i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale të natyrës së njëjtë.

I akuzuari T. N pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati N. dhe e ëma L e lindur A, i lindur më dt., në fsh. Zh, K. e V, ku edhe jeton, ka të kryer fakultetin e Gjeodezisë, me profesion gjeodet në Drejtorinë për kadastër pronë dhe Gjeodezi në Viti, (më herët kam qenë ushtrues detyre i drejtorit në drejtorinë për kadastër në Viti), i martuar pa fëmijë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar,

shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa gjykuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-ës.

Të akuzurit H. Aliu, F. H dhe T. N

LIROHEN NGA AKUZA

Më datë 02.05.2014 kanë keqpërdorë detyrën apo autoritetin zyrtarë në atë mënyrë që fillimisht e pandehura në cilësi të zyrtares ligjore në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe pronë në i në bazë të kërkesës së NSH "Agromorava" në Viti, ka hartuar dhe nënshkruar aktvendimin nr.248/14 duke bërë në mënyrë të kundërligjshme ndërrimin e titullarit të pronës së ngastrës kadastrale me nr... ZK S e Ega pronari N. B, NSH "A..." në Viti, ndërkaq të pandehurit në cilësi të përgjegjësit të kadastrit e UD. I drejtorit të kësaj drejtorie e ka nënshkruar këtë vendim të kundërligjshëm me ç'rast edhe të dëmtuarit i shkaktojnë dëme të konsiderueshme materiale.

Me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 të lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Meqë nuk është provuar se të akuzuarit Hidajete Aliu, Fadil Hoxha dhe Tajar Neziri kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

I dëmtuari L. B. nga fsh.SI e E K. e Vë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore Departamenti për Krime të Renda në Gjilan me datë 22.05.2015, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.280/14, ndaj të akuzuarve , për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që të njejtit të shpallen fajtor sipas ligjit.

*Ne fjalën perfundimtare Prokurori i shtetit **Afrim Shefkiu** mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ngritur ndaj të akuzuarve, ngase edhe gjatë seancave*

të shqyrtimit gjyqësor pamëdyshje u vërtetua se të njejtit kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës. Gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktit akuzues është vërtetuar qartas me administrimine provave materiale si në shkresat e lëndës veçmas me aktvendimin nr.248/14 të dt.02. maj 2014, aktvendim ky i nënshkruar nga ana e që të tre të akuzuarve. Nga ky aktvendim konstatohet se lejohet korigjimi i regjistrit kadastral i titullarit të pronës së palujtshme për ngastrën katastrale Nr.1589 të z.k. stubëll. Pra në këtë aktvendim të korigjuar është bërë ndryshimi i titullarit gjë që në bazë të shkresave të lëndës nuk kemi prova që aktvendimi ti jetë dorëzuar të dëmtuarit Laz Ballabani për të marrë formën e prerë apo eventualisht ti është dhënë mundësia e ankimimit e më pastaj ndryshimi si i tillë të bëhet, megjithatë ky ndryshim ka ndodhë. Poashtu gjendja faktike vërtetohet edhe nga provat tjera materiale edhe atë njoftimi nr..... i dt. 14.04.2014, lëshuar nga DGJKP Viti , çertifikata e pronës e dt. 05.11.2013, fletëposedimi i dt. ...(sipas sistemit KCID), fleta poseduese dhe kopja e planit të dt..., çertifikata mbi pronën nr....e dt. 11.08.2014, si dhe aktvendimi nr.214 i dt. 14.08.2007, lëshuar nga z.k. Viti. Poashtu gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar qartaz nga deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve Laz, dhe Frok Ballabani, të cilët në detale dhe në mënyrë kronologjike kanë përshkruar se si ka ardhur deri te ndryshimi i titullarit të pronës së kësaj palujtshmërie dhe se për çfarë arsye zyrtarët përkatësisht të akuzuarit Fadil Hoxha dhe Hidajete Aliu kanë shkuar deri tek shtëpia e tyre për të biseduar lidhur me gabimin në regjistrat kadastral. Është e drejtë e mbrojtjes dhe vet të akuzuarit që të justifikojnë veprimet e tyre mirëpo ndryshimi i titullarit të pronës pa i përfillë procedurat ligjore çoftë edhe mundësimi të ankimimit nuk ka guxuar me ndërrua, në rastin konkret kjo e drejtë i është kufizuar palës së dëmtuar e për pasojë është bërë ndryshimi në regjistrat kadastral ku edhe palës së dëmtuar i është shkaktuar dëm material siç është sqaruar vet. Andaj propozojmë që të akuzaurit të shpallen fajtorë për këtë vepër penale dhe të gjykohen sipas kodit penal.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar **L. B, av. E. Q**, në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë, në tërësi e mbështet deponimin e prokurorit të shtetit, me propozim që gjykata të vendos lidhur me kërkesën pasurore – juridike për të dëmtuarin në këtë çështje penale.

Mbrojtësi i të akuzuarës, fjalën përfundimtare të përgaditur me shkrim ia dorëzoi gjykatës (e cila do të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit), e të cilën në pika të shkurtëra e elaboroi, e në të cilin deklaroi, në vitin 2007, në bazë të kërkesës së Agjensisë Kosovare të mirëbesimit nr...., të dt.10.08.2007, e njëjta si menagjuese e ndërmarrjeve shoqërore ka kërkuar nga DGJKP në Viti, që të bëhet regjistrimi i ngastrës nr.... në sipërfaqe prej ..m katrorë, zona kadastrale në emër të ndërmarrjes shoqërore “Agromorava” në Viti, me çka ka prezentuar dokumentacionin valid të nevojshëm për ndërrimin e titullarit.

Në bazë të kërkesës zyrtari i DGJKPS ka nxjerrë aktvendimin nr.... të dt.14.08.2007, për regjistrimin e kësaj prone në emër të NSH “Agromorava” duke u bazuar në vendimin për eksproprijim nr....., i cili vendim ishte i shpallur në Gazetën zyrtare të KSAK me nr...7 të dt.24.05.1985, ku kjo ngastër me nr.1589-0 së bashku me bllokun e ngastrave të tjera të cilat përbënin kompleksin e fermës së dhive, ku janë të ndërtuara objektet – shtallat e dhive, kanë kaluar në emër të NSH “Agromorava” në Viti.

AKM-ja, si menagjuese e pronës shohqërore në Kosovë me deklaratën për transfer nr.1513/09 e dt.06.10.2009, e ka shitur si qirambajtëse për 99 vite, qiramarrësit Mentor Berishës nga Sadovina e Jerlive K. e Vitisë, i cili për shkaqe të tatimit të pa paguar të njëjtën me kohë nuk kishte mundur ta regjistrojë në emrin e tij. Ashtu që, meqë i njëjti nuk ishte regjistruar si pronar i ri ish pronari i viteve 1985, duke shfrytëzuar gabimin teknik të sistemit, kishte nxjerrë certifikatën e pronës kontestuese në emrin e tij, për çka DGJKP, në Viti ishte njoftuar, kurse blerësi kishte aplikuar për regjistrimin e kësaj ngastre së bashku me ngastrat e tjera në bazë të deklaratës për transfer nga AKP-ja në emër të tije. DGJKP-ja në Viti, duke e vërejtur gabimin e duke vepruar sipas ligjit për korrigjimin kadastral në lidhje me këtë ngastër me çka është e detyruar ta bëjë korrigjimin kadastral e cila ka nxjerrë vendimin për korrigjimin e regjistrit kadastral nr.... të dt.02.05.2014, ku palët kanë pasur të drejtën e ankesës në afat prej 30 dite të cilën të drejtë nuk e kanë shfrytëzuar, ashtu që zyrës kadastrale komunale iu është deleguar kompetenca nga Agjensioni kadastral i Kosovës për interpretimin ligjor të vendimeve për korrigjime. Në rastin konkret është siguruar interpretimi nga Agjensioni Kosovar kadastral dhe është vërtetuar se

procedura dhe vet vendimi i marrë ka qenë valid dhe në frymën e së drejtës materiale.

E mbrojtura ime nuk ka marrë aktvendimin për ndërrimin e titullarit të palujtshmërisë kontestuese, meqenëse i njëjti është marrë në vitin 2007 nga zyrtari tjetër i DGJKPS, ndërsa e njëjta ka marrë vendimin vetëm për korrigjimin e titullarëve në librat kadastrale në bazë të aktvendimit për ndërrimin e pronave të vitit 2007, ku edhe ky vendim ishte marrë në bazë të aktvendimit mbi eksproprijimin. Andaj në bazë të provave që janë shtjelluar në shqyrtimin gjyqësorë vërtetohet se e akuzuara Hidajete ka patur bekimin e Agjensionit kadastral të Kosovës për të bërë korrigjimin e gabimeve të ndodhura gjatë migrimeve të të dhënave. Ashtu që, e njëjta ka patur autorizime zyrtare për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me korrigjimin e shënimeve për ngastrën kadastrale tani kontestuese.

E akuzuara në rastin konkret në mënyrë të rregullt ka kryer punët dhe detyrat e punës të cilat iu janë besuar sipas pozitës dhe autoriteteve zyrtare, dhe në mënyrën e sugjeruar nga ana e Agjensionit kadastral të Kosovës – zyra ligjore me nr.031773/14 e dt.06.01.2015, ka mundur pa pengesa të bëjë korrigjimin në shënimet e librave kadastrale sipas vendimit për ndërrimin e titullarëve të palujtshmërive ku gjendet edhe palujtshmëria kontestuese e vitit 2007, e cila ishte mbështetur në vendimin mbi eksproprijimin nr.011-50 e dt.12.04.1985, e shpallur në gazetën zyrtare të KSAK nr.17 e dt.24.05.1985, andaj në veprimet e të akuzuarës nuk ekzistojnë tiparet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës. Propozon që në mungesë të provave të akuzuarën ta lirojë nga akuza.

E akuzuara, në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë në tërësi e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

*Mbrojtësi i të akuzuarit **F. H, av....**, fjalën përfundimtare të përgaditur me shkrim ia dorëzoi gjykatës (e cila do të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit), e të cilën në pika të shkurtëra e elaboroi, e në të cilin deklaroi: gjatë vitit 1995 KK, i Vitisë, kishte marrë vendim 011-50 të dt.12.04.1985, për shpalljen me interes të përgjithshëm të disa parcelave , e ndër to edhe të ngastrës kadastrale*

nr.1589, pronë e, nga Stublla e Epërme, e cila do të duhej të kalonte në pronësi të ndërmarrjes në themelim "Letnica", e cila ishte në kuadër të ndërmarrjes shoqërore "Agromorava" në Viti. Në të njëjtën pronë dhe në parcelat që janë përfshirë në eksproprijim është ngritur ferma e dhive dhe janë ndërtuar objekte përkatëse të nevojshme të cilat edhe tani ekzistojnë. Meqenëse për periudhën 1983 deri në 1999, kanë munguar regjistrat e tokës meqë ishin marrë nga regjimi serbë, me kërkesë të AKM-ës, të dt.10.08.2007, për regjistrimin e pronave të ish ndërmarrjes shoqërore "Agromorava" me aktvendimin me nr.214/07 të organit komunal për kadastër, është bërë ndërrimi i pronarit në bazë të vendimit mbi eksproprijimin me nr.011-50 të dt.12.04.1985, dhe parcela e lartë përmendur është regjistruar si pronë e NSH "Agromorava", dhe meqenëse kanë ekzistuar dy sisteme të regjistrimit të të dhënave, e njëjta pronë ka figuruar gabimisht edhe në emër të ish pronarit Nue Ballabanit, i cili ia kishte bartur djalit të tij... Meqenëse prona e ish NSH "Agromorava" ishte shitur pronarit privat i njëjti ka kërkuar gjatë vitit 2014, të bartet pronësia në emrin e tij dhe pas procedurave të nevojshme zyrtare është bërë korrigjimi i të dhënave dhe si pronar, në vend të evidentohet pronari N.B.I.Q. "Agromorava", dhe për këtë korrigjim njoftohet edhe ish pronari ...rrespektivisht djali i tij..., në emrin e të cilit i kishte bartur pronësinë mbi parcelën kontestuese, e i cili nuk ka parashtruar ankesë në këtë njoftim edhe pse edhe gojarisht në shtëpinë e tij është njoftuar nga zyrtarët. Për korrigjimin e të dhënave është kërkuar edhe mendimi i Agjensisë kadastrale të Kosovës, e të cilët kanë dhënë përgjigje se "Aktvendimi" mbi korrigjimin e regjistrat kadastral është bërë duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi (përgjigje 031773/14 të dt.06.01.2014 dhe përgjigja e dytë e dt.02.12.2015).

Ka propozuar që i akuzuari Fadil Hoxha në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

*I akuzuari **F. H** në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë në tërësi e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.*

*Mbrojtësi i të akuzuarit **T. Ni, av. Rr.L**, fjalën përfundimtare të përgaditur me shkrim ia dorëzoi gjykatës (e cila do të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit), e të cilën në pika të shkurtëra e elaboroi, e në të cilin deklaroi: i mbrojturi im gjatë punës, që nga fillimi kur është caktuar apo zgjedhë drejtor*

komunal në kadastër, gjeodezi e pronë nuk e ka keqpërdorur pozitën - detyrën apo të ketë bërë ndonjë tejkalim të autorizimeve, apo t'i ketë sjellë vetit përfitim apo personit tjetër, e në rastin konkret nuk i ka shkaktuar kurrfarë dëmi Ilaz Ballabanit respektivisht N.B.

Lidhur me këtë çështje penale - juridike janë dëgjuar edhe dëshmitarët A.SXh. Sh., gjeodet në Drejtorinë për Gjeodezi pronë dhe kadastër në Viti, pastaj edhe Edona Kutllovci nga Agjensia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të cilët bindëshëm kanë pohuar, se zakonisht kur lëshohen gabimet ato edhe korrigojnë, në rastin konkret edhe është bërë korrigjimi me vendim si në shkresat e lëndës.

Korrigjimet bëhen në çdo rast kur të lëshohen gabimet, që nuk është e kufizuar në kohë apo edhe vend, e që edhe tani ka raste të cilat korrigojnë vetëm duke poseduar dokumentacionin përkatës dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Një fakt i tillë është vërtetuar edhe me aktvendimin e dt.15.12.2014, sipas referencës 03/1521/14 të lëshuar nga zyra ekzekutive e Agjensisë kadastrale të Kosovës, e cila ka vërtetuar aktvendimin e Drejtorisë për kadastër , pronë dhe gjeodezi në Viti me nr.495/14 të dt.27.08.2014. Parcela me nr.1589-0 në sipërfaqe prej 793 m² , është eksproprijuar për interesa të përgjithëshme - shoqërore "Letnica", e cila është eksproprijuar që në prill të vitit 1985. Nga Kuvendi Komunal i Vitisë i cili edhe është shpallur në fletoren zyrtare, në të cilën sipërfaqe është ngritur edhe miniferma e dhive, jo vetëm të kësaj parcele por edhe të tjera, më pastaj edhe me kalimin e kohës dhe ndërrimin e sistemeve është bërë edhe tjetërsimi duke kaluar nga personat privat, shoqërore, pastaj në AKP e tani në personin tjetër.

Propozon që i akuzuari T. N mungesë të provave të lirohet nga akuza.

I akuzuari T. N, në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësorë në tërësi e përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

I dëmtuari L.B si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë deklaroi: palujtshmëria me nr.1589 ZK stubëll e Epërme, është e evidentuar në emër të babait tim Nue Ballabani. Nuk kam njohuri se si ka ardhur deri te

ndryshimi i këtij titullari. Në vitin 2013, kah mesi i gushtit prona e babait tim ka kaluar në emër timin. Këtë veprim e kemi bërë në Kadastër në Viti, kemi shkua te noteri me babain tim, dhe këtë pronë e kam qitur nga babai im në emrin tim dhe për këtë kam marrë edhe certifikatën në Drejtorinë gjeodete, dhe në muajin shtator të vitit 2013, kjo pronë ka kaluar në emrin tim. Në maj të vitit 2014, ishim në pushim z, e kishin ftuar vëllain tim me e gjet askund, vëllai më thirri ku je a je në shtëpi se më kanë ftuar prej Kadastrit një zë femre me telefon dhe kanë ardhur z. me gjithë z. e, në shtëpinë time, kemi biseduar me ta dhe më tha se është bërë një mosmarëveshje, e prezentoj hartën, dhe dokumentet e tjera dhe më tha se është bërë një mosmarëveshje dhe duhesh të nënshkruajsh. Unë nuk pranova në shtëpinë time ta nënshkruaj atë dokument të cilën ma ofruan dhe ju thash që do të vij nesër në Kadastër të Vdhe të sqaroj për çfarë problemi është fjala, dhe plus një ftesë ma kishin pas quar për tu lajmëruar, unë u lajmërova në zyrën e, e që i njejtë nuk kishte qenë në zyre, nga kjo zyre dola në zyrën e z. e njejtë mi ofroi disa letra që ti nënshkruaj, dhe pak a shum më sqaroi se ky nënshkrim duhet të bëhet për shkak të pronës që gjendet te mulliri. Unë nuk pranova që ta nënshkruaj atë dokument dhe i thash se nuk kam pronë për tia falur ndokujt. Të njejtës ia prezentova kopjen e planit në origjinal – listën poseduese, në emër të me nr. 12.562 nga drejtoria e përgjithshme gjeodete, me nr. të fletës poseduese .. të dt.06.06.1985, si dhe ekstrakti nga fletposedimi me nr....të dt.19.08.2003, e njejtë mua më tha neve nuk na interesojnë këto të vitit 1985 dhe të vitit 2003, por më tha se më e vlefshme është e vitit 2009, mirëpo e njejtë dokumentet e vitit 2009, fare nuk mi ka prezentuar aty. Unë besoj se të gjitha dokumentet lidhur me këtë pronë i kanë pa, i kanë pasur në dorën e vet të pandehurit në fjalë, meqë të njejtat janë lëshuar nga ana e Kadastrit.

Më dt. 11.08.2014, më nevoiteshin dokumentet, shkova në Kadastër në Viti, për ta kërkuar certifikatën e pronës, dhe aty e vërejta se prona te mullini - te reka nuk kishte qenë fare. Me njëherë jam lajmëruar te F, iu kam drejtuar të njejtit se kush ma ka hjekur nga dokumentet pronën time dhe i njejtë më tha se nuk mundem me të treguar arsyen se përse kjo pronë ka kaluar në emër të. F më tha mundem me ta dhënë atë dokument por nëse të shërben për gjykatë ta jap. F ma dha dhe e mora certifikatën që ishte në emër të, e unë e pyeta pse është qitur kjo pronë në emër të dhe kush e ka nënshkruar, F më tha se kjo është punë e jona. Unë nuk kam njohuri se në vitin 1985, se kjo pronë të jetë eksproprijuar

nga Komuna e atëhershme. Unë kam biseduar me babain tim, dhe i njeiti më ka thënë se kur nuk është kompensuar kjo pronë. Për herë të parë sot në gjykatë e shoh të pandehurin e tretë që është i ulur në ulësen e të akuzuarve, dhe me të njejtin kur nuk kam biseduar – kontaktuar për pronën në fjalë përveç sot që po e shoh këtu. Në shtëpinë time, kur kanë ardhur H dhe F prezentë kanë qenë vëllai im F.B dhe bashkëshortja e tij . Shtoj edhe këtë se unë personalisht kam shkuar në Krushëfc të Serbisë – në kadastër dhe kam siguruar fletën poseduese me nr..... të dt.17.11.2014, që kjo pronë ka qenë dhe është në emër të babait tim, kopja e planit me nr.953 -1/2014-282 të dt.17.11.2014.

Këtë palujtshmëri nga viti 1985, e ka shfrytëzuar Komuna e Vitisë dhe atë para luftës. Kjo pronë është shfrytëzuar për shtallë të dhive. Më herët kjo pronë ka qenë mulliri i Ballabanëve. Unë nuk e di se a kanë marrë edhe ngastra të tjera. Unë nuk e di që dikush është ftuar nga ana e organeve kompetente që të sqarohet për këtë çështje. Tatimin e pronës nga viti 1985 e deri pas luftës ka paguar baba im meqë e njehta pronë ka qenë në emër të tij. Unë nuk kam kurfarë vendimi të AKM lidhur me këtë pronë. Gjatë vitit 1985, babai im ka parashtruar ankesë në Komunë apo në gjykatë mirëpo nga ana e askujt nuk është ndërmarrë kurfarë veprimi. Unë punoj dhe jetoj në Vienë të Austrisë qe 35 vite.

Avokati M. Me ballafaqon të dëmtuarin me deklaratën e tij të dhënë në polici në faqen e tretë pasusi i parë ku citon: “ pasi që ju e kuptuat se parcela nr.1589, të është bartuar nga babai i juaj te “Agro Morava” a keni bërë ndonjë padi në gjykatë për ta kthyer pronën në fjalë” përgjigja ka qenë jo për arsye financiare.e di që babai im në gjykatë padi nuk ka ushtruar, ndërsa në Komunë ka bërë ankesë dhe nuk ka marrë kurfarë përgjigje.

Po është e vërtetë se në shtëpinë time i ka qitë dokumentet që unë ti nënshkruaj. Unë nuk e di arsyen pse nuk kemi marrë përgjigje nga ana e organeve kompetente kur babai im ka paraqitur ankesë.

Unë nuk kam patur dhe nuk kam njohuri që kjo patundshmëri ka kaluar në ankand publik përmes AKM.

Dëshmitari **F.B** nga fsh. S. e E (i dëgjuar me kërkesën e prokurorit), dëshmon: ajo pronë ka qenë e jona edhe atë “”, kohë pas kohe që ia ka marrë shteti babës në atë kohë , pa kurrfarë kompensimi. Kjo pronë ka qenë e

regjistruar në emër të babait tim. Unë në atë kohë kam qenë në Austri dhe kur jam kthyer babai im më ka njoftuar se pronën e ka uzurpuar shteti i Jugosllavisë. Të pandehurin e njoh vetëm si figurë, ndërsa të pandehurit Hidajete i kam parë atë ditë kur kanë ardhur në shtëpinë time. Në shtëpinë time kanë ardhur e pandehura H, kanë hyrë brenda, F ka nxjerrë nga çanta e tij disa dokumente, dhe i është drejtuar vëllait tim është bërë një gabim me AKP-ën ose AKM nuk e di, dhe F i ka thënë a mundesh të na japësh një autorizim se kemi disa probleme lidhur me pronën e mullirit, e që në atë kohë ka qenë fermë e dhive. Laz Ballabani nuk e nënshkruajti atë autorizim të cilin ata e kishin pas të pregaditur e Laz Ballabani të nënshkruhet, mirëpo i njëjti nuk ka pranuar dhe nuk e ka nënshkruar. Kemi shkuar me vëllain të nesërmen në Viti – në gjeodezi përkatësisht vëllai ka hy brenda e unë kam pritur poshtë, e që Laz nuk e ka nënshkruar përsëri këtë autorizim meqë edhe në shtëpi paraprakisht ne u murëm vesh që të mos nënshkruhet ky dokument, dhe se ne dojmë ta mbrojmë pronën tonë. Me plot bindje deklaroj se kjo pronë asnjëherë nuk na është kompensuar nga ana e komunës së Vitisë e për këtë jam njoftuar nga babai im dhe se lidhur me këtë çështje kemi biseduar edhe më herët. Dhe çdo herë kur është hapur kjo bisedë unë me vëllain tim e kemi pyetur babain tim se përse e ke dhënë këtë pronë, e nga ai kemi marrë përgjigje “se nuk kam patur qare pa ia dhënë, meqë shteti na e ka marrë”. Asnjëherë nuk është paguar tatim shtetit lidhur me këtë pronë, dhe nuk e di a kan bere padi ndonjëherë ne gjykate lidhur me pronën e marre. Unë nuk e kam parë autorizimin të cilin ia ka ofruar i pandehuri Fadil vëllait tim në shtëpi dhe nuk e kam lexuar përmbajtjen e atij dokumenti. Pas luftime nuk kemi bërë kërkesë komunës që kjo pronë të na kompensohet. Meqë nuk kemi patur kohë të mirremi me këtë punë.

Dëshmitari **A. S**, nga fsh.B. e E, si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë deklaroi: unë punoj në Drejtorinë për gjeodezi kadastrë në Viti, detyra ime është referent i ndërrimeve pronës, kontratës së shitblerjes, kontratën mbi falje, aktgjykimeve të gjykatës, regjistrimin e hipotekave. Unë bëj edhe ndërrimin e aktvendimeve në drejtorinë për gjeodezi pronë dhe kadastrë. Unë kam njohuri lidhur me aktvendiimin me nr.të protokollit 248/14 të dt. 02.05.2014, kur edhe është lejuar korigjimi i regjistrimit kadastral të titullarit të pronës së pa lujtshme, njësia kadastrale nr.1589-0 e cila gjindet në zonën kadastrale Stubëll e epërme, nga ish pronari dhe këtë mund ta sqaroj:

Ajo ka qenë pasuri e tij private e ose e prindit të tij, pastaj është bërë eksprorijimi në parcela aty është ndërtuar ferma e dhive, ajo është dashtë ta kaloj në NBIQ "Agro Morava" në Viti. Agro Morava e ka qitur në shitje edhe është bartë tek pronari i ri. Pronari i ri quhet ia ka shitur pronarit tjetër Qazim Ibrahimit. Në fillim kanë funksionuar 2 sisteme, fillimisht ka qenë sistemi KCID, i cili ka funksionuar deri në vitin 2000. Nuk më kujtohet se në emër të kujt ka qenë më herët. E di se ka ardhur në zyrën kadastrale në Viti për të kërkuar pasurinë e vet. Ai ka mundur ta gjej në emër të vetin këtë palujtshmëri. Tani nuk më kujtohet se i njejt i ka sjellur në kadastër ndonjë dokument të vetin apo e ka lypur këtë palujtshmëri në emër të tij. Nëse nuk gaboj në vitin 2007 është nxjerrë një aktvendim mbi korigjimin, të cilin aktvendim e ka nxjerrur juristi me të cilin aktvendimin mbi korigjimin është bërë ndryshimi sipas sistemit RDPP (regjistri i të drejtave të pronave të palujtshme), kur është bërë ndryshimi atëherë Agro Morava e ka qitur në shitje në atë kohë. Sipas aktvendimit 248/14 të dt. 02.05.2014, këtë ndryshim e kam bërë unë ose kolegu im, meqë që të dy jemi operator të ndërrimeve. Me fjalën korigjim nënkuptoj, gabimet në emra, shifra, mbiemra dhe zakonisht sistemi që punojmë nganjëherë na e qet ndonjë pronar të qytetit tjetër vet sistemi mund të na i përzijë emrat, e që ne jemi kompetent që ta bëjmë korigjimin e të njejtave.

Ndërsa me ndërrim të titullarit kuptoj, kontratat e shitblerjes, aktvendimet e gjykatës, ne edhe në emër të drejtorisë tonë nxjerrim aktvendime mbi korigjimet e titullarit në rastin konkret. Unë nuk e di se a lejohet me aktvendim korigjimi i ndërrimit të titullarit. Drejtoria e jonë e ka bërë kërkesën në agjensionin kadastral të Kosovës për ta mësuar ne a kemi të drejtë apo jo të bëjmë korigjimin e ndërrimit e titullarit. Nuk më kujtohet se kjo kërkesë a është bërë para marrjes së aktvendimit me nr...., apo pas.

Nuk më kujtohet saktësisht se çfarë përgjigje, në bazë të kërkesës sonë kanë dhënë agjensioni kadastral i Kosovës por e kemi një shkresë në drejtori. Pas eksproprijimit të kësaj palujtshmërie ka pasur ndryshim të pronës dhe ka qenë e regjistruar në emër të Agro Moravës si pronë shoqërore. Në drejtorinë tonë, ndodhë shumë shpesh që të marrin aktvendime mbi lejimin e korigjimit të pronave. Vlerësimi i punëtorëve bëhet për çdo fundvit, dhe sa i përket të pandehurve të ulur në bankën e të akuzuarve besoj se nuk ka punëtorë më të

mirë në drejtorinë tonë dhe jo rastësisht nuk janë caktuar për përgjegjës të sektoreve. Nuk jam i sigurtë por e pandehura duhet ta ketë ndonjë mirnjohje nga organi i lartë.

Është e mundur shpesh herë që të ketë defekte në sistem. Në certifikatën e pronës që e kam unë para vetës, ...pos numrit personal ekziston edhe një numër identifikues, për shembull ky numër mund të jetë i njejtë me një numër i cili është në një qytet tjetër. Ka edhe raste të ngjajshme si ky rast i cili është objekt i akuzës, që të bëhet ndërrimi gjegjësisht kontrollimi i titullarit të pronës dhe atë shumë shpesh nga ana e drejtorisë sonë. Kjo palujtshmëri tani figuron në emër të Qazim Ibrahimit i cili e ka blerë nga M.B.

E në pyetjen e prokurorit se në bazë çkafit më dt. 05.11.2013, i është lëshuar certifikatë e pronës L. B, ekziston vula dhe nënshkrimi i personave zyrtarë, dëshmitari përgjigjet:

Sigurisht personat zyrtarë e kanë gjetur kështu në sistem dhe e kanë lëshuar certifikatën e pronës.

Tani funksionin sistemi K. Për shkak të ndërrimeve të këtyre sistemeve është shfrytëzuar vakumi dhe ka ardhur deri te lëshuarja e kësaj certifikate të pronës në emër të Laz Ballabanit, çka do të thotë se që nga fillimi kanë funksionuar 3 sisteme edhe atë e para KCLIS.

*Dëshmitari **Xh. Sh.** fsh. T, si gjatë fazës së hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë deklaroi: unë punoj në sektorin e kadastrit si operator i ndërrimeve në KK.Viti. Detyrat e mia janë: bëhen ndryshimet në librat e kadastrit dhe atë në bazë të kërkesës së palëve dhe në bazë të vendimit që lëshohet nga juristi i drejtoratit. Kërkesës së palës i bashkangjitet kontrata e shitblerjes e palujtshmërisë, kontrata e faljes, aktgjykimet e gjykatës etj. unë nuk kam qasje në aktvendimin me nr.të protokolit 248/14 të dt. 02.05.2014, të lëshuar nga kjo drejtori. Këtë ndryshim të këtij titullari e ka bërë kolegu im. Me fjalën korigjim nënkuptoj gabimet në shifra, në shkronja, në emra, dhe nëse vërejmë ndonjë gabim të tillë, kemi historiatin e kadastratit dhe i shtjellojmë gjërat të cilat duhet të bëhet korigjimi. Kompetent për me bërë korigjimin është juristi. E pandehura Hidajete në drejtoratin tonë është juriste. Korigjimi në titullar mund të bëhet në bazë të shenimeve që i kemi në aparatit kadastral dhe vërtetohet*

se është bërë gabimi dhe në bazë të kësaj mund të bëhet korigjimi i titullarit. Unë nuk e di se kjo palujtshmëri është në emër të dhe Agro Moravës, ngase thash edhe më parë se nuk kam qasje në aktvendimin me numër dhe datë si më lartë. Unë nuk e di dhe nuk kam spjegim për atë se si është lëshuar çertifikata e pronës më dt. 05.11.2013, në emër të. Unë e di se ku është ferma e dhive, dhe nuk e di se kush e shfrytëzon të njejtën. Unë as që e njoh dhe nuk e di se i njejtë a ka ardhur ndonjë herë në kadastrë.

Unë e di se edhe më herët kemi pasur aktvendime të llojit të tillë dhe kemi bërë korigjimet e titullarëve. Unë me sa e di gjatë vitit 2002 është përdorë në drejtorat sistemi KCID, i cili sistem ka përfunduar në vitin 2005, e në vitin 2007 kemi startuar me sistemin RDPP, ky program ka zgjat deri në muajin qershor të vitit 2013, dhe prej qershorit të vitit 2013 e tutje kemi sistemin KCLIST. E di se disa herë kemi bërë kërkesa në agjensionin kadastral të Kosovës për sqarime, e nga të njejtit kemi marrë disa herë përgjigje se gabimet të cilat i vreni në drejtorat dhe gabimet të cilat ndodhin mund të bëni korigjimet. Dua të sqaroj se ne kemi kërkuar sqarim në shkallën e dytë e kjo do të thotë në Agjensionin Kosovar Kadastral. Unë jam në këtë drejtorat jam duke punuar nga 31 marsi i vitit 2002 e që akoma këtu jam duke punuar, dhe kam njohuri meqë jam punëtor i vjetër në këtë drejtorat gjithmonë kemi patur fjalë të mira për të pandehrit për punën e tyre që kanë punuar në nivel komunal, të njejtit kanë patur edhe mirnjohje për punën që e kanë bërë.

Me pëlqimin e palëve është lexuar deklarata e dëshmitarës E:K të dhënë në Prokurori më dt. 02.02.2015, e në të cilën deklaron: në AKP – Departamenti Ligjorë jam e sistemuar në vendin dhe detyrat e punës zyrtare e lartë ligjore dhe kryesisht i kryej punët me sa vijon: shqyrtoj ankesat e palëve, vendimet e zyrave kadastrale komunale, komunikoj me palë, jap udhëzime e rekomandime për zyrat kadastrale që na drejtohen përkatësisht lidhur me vendimet që merren në këto zyre. E në pyetje të prokurorit se a jeni nënshkruese e shkresës me numër reference 03/1773/14 të dt. 06.01.2015, dëshmitari përgjigjet “me përgjegjësi të lartë morale dhe ligjore dëshmoj para jush se drejtoria për kadastrë, pronë dhe gjeodezi, kuvendi komunal në Viti me parashtrësën me nr. 03/1773/14 të dt. 22.12.2014 na është drejtuar për të dhënë sqarim në lidhje me regjistrimin e pronës – parcelës me nr. ..zonë kadastrale. Ne jemi përgjigjur më dt. 06.01.2015

me një shkresë protokoluar me nr. 031773/14, me të cilën kemi konfirmuar se drejtoria për kadastër, pronë dhe gjeodezi K. V ka nxjerrë vendim për korrigjimin e regjistrit kadastral të cilin e ka arsyetuar dhe bazuar nga gabimet teknike që kanë ndodhur në të kaluarën. Në aspektin procedural ka qenë çdo gjë në rregull, dhe si shkallë e dytë e kemi lëshuar atë përgjegje në kërkesë.

Por, në aspektin material të vendimit nuk përmbajmë përgjegjësi për ndërrimin e pronarëve gjegjës. Përfundimisht ne si agjensi kadastrale e Kosovës, organ i shkallës së dytë për gjeodezi dhe kadastër në Kosovë sipas ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronave të paluajtshme dhe ligjit nr. 04/L13, për kadastër veprojmë sipas ankesave të personave të interesuar dhe vendosim për rishqyrtimin e vendimeve të organit të shkallës së parë, ndërsa në rastin konkret ne vetëm kemi konfirmuar se vendimi me nr. 248/2014 i dt. 02.05.2014, i lëshuar nga drejtoria për kadastër, pronë dhe gjeodezi në Viti është konform dispozitave ligjore. Ne aspektin procedural sipas detyrës zyrtare kane pasur te drejte me bere korrigjimin e regjistrit, e ne pyetjen e prokurorit se a nënkupton kjo edhe ndërrimin e titullarit te pronës dëshmitarja pergjigjet. Une kam dhene përgjigje ne kërkesën e Drejtorise per Gjeodezi kadastër dhe prone, përkitazi me rrespektimin e procedurave te korrigjimit te aktvendimit, ndërkaq ne aspektin permbajtesore te aktvendimit nuk jemi lëshuar duke qene se aktvendimi ne fjale paraprakisht ka qene i nxjerrur nga drejtoria përkatëse. Si zyrtare ligjore ne AKK jam duke punuar qe nga muaji tetor ndërkaq me pare kam punuar si keshilltare ne projekte.

E akuzuara **H, A** nga Gj, si ne hetuesi ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi: une qe 5 vite punoj në Drejtorinë për Kadastër pronë dhe gjeodezi në K. e Vitisë. Vendimi mbi regjistrimin e palujtshmërisë që është bërë me kërkesën e Agjensisë Kosovare të mirbesimit me dt. 10.07.2007, kam bërë kërkesë në Drejtorinë për Kadastër gjeodezi pronë në Viti, për regjistrimin e pronave të NBIQ "Agromorava", është marrë vendim më dt. 14.08.2007, me nr. 2014-2007 nga ish zyrtari i më hershëm që ka punuar R. F, në bazë të vendimit të eksproprijimit në vitin 1985 që ka qenë, është shpallë zonë me interes për ndërtimin e fermës së dhive, ai projekt është përfunduar në këto palujtshme, është ndërtuar ferma e dhive edhe ka funksionua. Ky vendim ka qenë i publikuar në gazetën zyrtare të me nr. 17 të dt., po ka pasur edhe parcela tjera të cilat iu

kanë bashkangjitur këtij kompleksi, edhe me të njehta është vepruar si me ngastrën kontestuese – e njehta procedurë ka shkuar edhe me ngastrat tjera. Po është e vërtetë se pas marrjes së këtij vendimi është njoftuar pala do me thënë më dt. 14.04.2014, kur ne e kemi bërë korigjimin, dhe ndaj vendimit tonë pala ka patur të drejtë ankese prej 30 ditëve, të cilën pala nuk e ka shfrytëzuar, e në këtë rast këtë të drejtë nuk e ka shfrytëzuar. Po ka qenë i njoftuar Agjensioni kadastral i Kosovës – shkalla e dytë zyra ligjore ku kemi kërkuar interpretim të vendimit dhe na është kthyer një përgjigje me dt. 06.01.2015, se korigjimi të cilin e kemi bërë është duke u bazuar në ligjet në fuqi. Është ligji mbi kadastrin neni 17 pika 1 dhe 3 numri i ligjit 04/L013 dhe udhëzimit administrativ neni 19 pika 2 nr. i udhëzimit është 02/13, që e lejon korigjimin e regjistrit kadastral. Këto palujshshmëri me vendimin 2007 që është marrë më herët AKM i ka nxjerrë në shitje edhe e ka blerë një person me emrin Mentor Berisha, komplet fermën e dhive ku në mesin e tyre ka qenë parcela e Laz Ballabanit. Këtë kompleks e përbëjnë afërsisht 10 parcela, e në mesin e të cilave edhe parcela kontestuese. Me objekte të fermës së dhive janë të përfshira edhe ngastrat e tjera. Kanë figurua komplet në emër të personave tjerë në mungesë të dokumenteve e pas luftime gjendja është kthyer në vitin 1983 në kadastër dhe do të thotë kanë munguar regjistrimet prej vitit 1985 e gjer në vitin 1990, të gjitha regjistrimet mungojnë, dhe kjo është pasojë e marrjes së dokumenteve nga ish pushteti serb. Unë mendoj në bazë të ligjit mbi kadastrin neni 5 pika 3 të cilat AKGJ i delegon kompetencat në zyret komunale kadastrale për regjistrime, korigjime dhe mendoj se në bazë të ligjeve unë dhe kolegët e mi tani të pandehurit kemi vepruar në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi. Po kemi pasur raste ku pala është ankuar kemi rastin konkret zonën kadastrale të Kabashit e kemi një parcelë nr. i njejsisë 1061 e cila ka figurua në emër të Agromoravës, kemi vepruar njejtë, kemi nxjerrë vendimin në procedurë të rregullat AKP ka ushtruar ankesë shkallës së dytë Agjensionit kadastral zyrës ligjore me çka me vendim prej zyrës ligjore të agjensionit ankesa është refuzuar prej AKP dhe është vërtetuar vendimi i drjetorisë tonë.

Pozita ime në DGJKP është zyrtare juridike. Po aktvendimin me nr.248/2014 të dt. 02.05.2014, unë e kam hartuar dhe të njejtën e kam nënshkruar. Është e vërtetë se për këtë ndryshim e kam njoftuar të dëmtuarin Laz Ballabanin si dhe prindin e tij, dhe atë me shkrim përmes protokolit të

Komunës. Dhe atë me numër të njoftimit 07-07/521 i dt.14.04.2014. Unë në këtë drejtori kam punuar që nga qershori i vitit 2011, e ne pyetjen si e spjegoni faktin se gjatë kontrollimit të dosjes së përkatësisht figurojnë tri lista poseduese edhe atë lista poseduese nr.18 e dt.19.08.2003, ku parcela nr.1589 figuron në emër të, lista poseduese nr.260 e dt.15.08.2007, ku e njejta parcelë figuron e Agromoravës ndërkaq lista poseduese nr.18 e dt.14.08.2014, figuron në emër të?

Përgjigjet: para vitit 2011, nuk mundem me u përgjigjë sepse në atë kohë nuk kam punuar, sa i përket fletës poseduese 2014 kemi pasur sistemin RDPP dhe prej korrikut të vitit 2013 kemi sistemin e ri tash që punojmë KCLIS mirëpo kemi pasur gabime që janë bartur me migrim edhe prona e Las Ballabanit do me thënë ka kaluar në emër të L për arsye se pronari i cili e ka blerë komplet fermën e dhive ka aplikua në drejtorinë tonë për regjistrim në vitin 2009 mirëpo për shkak të pagesave të tatimit në pronë që ka qenë kusht për regjistrim nuk e ka regjistrua edhe me kalimin e sistemit të ri është bartë ky gabim dhe prona e tij ka kaluar në emër të. Gjithashtu dua të potencoj edhe këtë se nga Agjensioni kadastral nga drejtori i departamentit të kadastrit me nr.03/46/14 e dt. 19.01.2015, të korigjuar gabimet e ndodhura nga migrimet e të dhënave që janë bartë prej një sistemi në tjetrin sistem. Është e vërtetë se unë me kolegun Fadil Hoxha i cili ka qenë kryetar i komisionit për regjistrimin e banesave kemi qenë në fsh. Letnicë për evidentimin e banesave edhe të njetjën kohë jemi kthyer e kemi dashur me vërtetua se a është pala këtu dhe a e ka marrë një njoftim i cili njoftim është përcjellë përmes protokollit të komunës. I njejt kishte qenë në shtëpi dhe ne e njoftuam lidhur me njoftimin se a e ka marrë njoftimin apo jo, i njejt u përgjigj se nga ana e komunës nuk kam marrë njoftim. Ne atë ditë nuk kemi kërkuar nga Laz Ballabani që të vijë në Komunë dhe me bërë një proces se është bërë një gabim. Ne nuk e kemi njoftuar që të angazhoj ndonjë avokat lidhur me atë gabim. Me fjalën ndryshim kuptojmë kur bëhet ndryshimi komplet i titullarit, ndërsa me fjalën korigjim kuptojmë kur bëhet korigjimi i të dhënave në regjistrat kadastral, rastin konkret e kemi d.m.th është korigjua numri i njësisë. Nuk nënkupton ndryshimi i titullarit se ka qenë vendimi i vitit 2007 që iu ka njohur e drejta e regjistrimit të titullarit, dhe konsideroj se është e drejta e jonë që me aktvendim korigjues bëjmë ndërrimin e të dhënave në regjistrat kadastral, e kjo nuk nënkupton që të bëhet edhe ndryshimi i titullarit, për rastin konkret titullari është ndryshuar në vitin 2007, në kohën kur unë nuk kam

punuar, kur është bërë ky ndërrim. Edhe një herë e sqaroj se unë kam korigjuar aktvendimin mbi regjistrat kadastral dhe me këtë aktvendim të shenimeve të librave kadastrale. Ne jemi konsultuar që të tre bashkarisht e kemi përpiluar aktvendimin dhe ka qenë i vetëdëshëm dhe e ka nënshkruar të njëjtin aktvendim në cilësi të drejtorit e paraprakisht jemi konsultuar edhe me agjensionin e ata na kanë sugjeruar.

Përveç që kemi shkuar në shtëpinë e, takim tjetër me te nuk kemi pasur meqë i njëjti nuk është paraqitur asnjëherë në Komunë - në drejtorinë tonë lidhur me rastin në fjalë. Kjo do të thotë se edhe në zyrën time i njëjti nuk ka qenë asnjëherë për arsye se ai kishte qenë i vetëdëshëm për atë gabim dhe kishte menduar që përmes atij gabimi teknik të përfiton. Kemi edhe ligjin mbi regjistrimin e të drejtave 2002/5, ndryshimi dhe plotsimi i këtij ligji 2003/13 për regjistrimin e palujtshmërisë, të cilat ligje edhe ne i zbatojmë për regjistrimin e palujtshmërive.

Lidhur me këtë rast askush nuk ka patur ndonjë përfitim material. Unë nuk kam njohuri se a i është kompenzuar të dëmtuarit Laz Ballabani me rastin e eksproprijimit të kësaj palujtshmërie.

I akuzuari F. H. si gjate fazës se hetimeve ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqësor, deklaroi: Unë punoj në Kadastër që nga viti 2000 e deri më sot, dhe kam punuar edhe nga viti 1988-1990, me të njëjtën punë që e kam bërë edhe atë herë edhe tash, aëtherë kam qenë si gjeodet e tash jam zyrtar ligjor. Kur është fjala për parcelën me nr.1589 e cila është objekt i kësaj akuzës është eksproprijuar gjatë vitit 1985, dhe si dëshmi kemi gazetën zyrtare nr.17 te dt.24 maj 1985, me te cilën është shpallur interesi i përgjithshëm mbi ngastrat ne fjale.

Mirpo për shkak të azhurimit, për shkak të plaqkitjes së dokumentacionit ZK në Viti posedojmë me shenimet e vitit 1983-1985, ndërsa periudha prej vitit 1983 – 1985, deri pas luftës është plaqkitur nga Serbia, të cilën nuk e posedojmë. Në vitin 2007 në vazhden e privatizimit AKM-ja ka bërë kërkesë në zyrën kadastrale në Viti për regjistrimin e të dhënave kërkesa është e dt. 10.gusht 2007, e që këtu e kundërshton edhe aktakuzën meqë ka qenë kërkesa e AKM e jo e Agromoravës. Këtë ndërrim të kësaj palujtshmërie e ka bërë zyrtari juridik i

atëhershëm, me aktvendimin nr. 2014/07. Pas kësaj AKM e ka nxjerrë në valën 27 të shitjes me çka është privatizuar ose është dhënë në qirambajtje në afat prej 99 viteve e që blerës ka qenë, i cili ka ardhë për ta regjistruar pronën në emër të tij mirëpo për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit i ka munguar tatimi në pronë e njehta nuk i është regjistruar në ndërkohë – dua të sqaroj se kjo është shitur në vitin 2009, gjegjësisht deri në vitin 2014, kur ka ardhur për ta regjistruar pronën është vërtetuar se prona ka kaluar prap në emër të Laz Ballabanit për shkak të gabimeve gjatë transferimit nga sistemi. Pastaj duke e parë këtë gjendje meqenëse pronari legjitim tani ishte blerësi nga AKM-ka, zyrtarja juridike ka nxjerrë aktvendimin mbi korigjimin e regjistrimit i cili është kontestues tani, me të cilin është korigjuar regjistri kadastral paraprakisht janë marrë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme që duhet të jenë rreth korigjimit kadastral në fjalë. Që nënkupton se është rrespektuar shpallja publike, i është dërguar palës njoftimi se do të bëhet korigjimi kadastral nëpërmjet arhivës komunale. Meqë kemi pasur njohuri se pala nuk gjindet këtu, diku gjindet në Austri në një rast kur unë kam qenë kryetar komisioni për regjistrimin e banesave për të cilat ekziston e drejta e blerjes ishim në Letnicë për vërtetimin e një banese që ishte djegur, gjatë kthimit kolegia ime Hidajete propozoj që të shkojmë deri te në mënyrë që të informohemi se a e ka marrë njoftimin apo jo, meqë paraprakisht kishim informata se i njehti gjindet në shtëpi. Shkuam në shtëpinë e tij hymë brenda, edhe e pyetëm atë se a e ke marrë një njoftim dhe kemi arrdhë të njoftojmë se do ta bëjmë një lloj korigjimi për parcelën në fjalë, ai na priti shumë mirë me familjen e vet dhe asnjë fjalë kundërshtuese nuk e ka thënë lidhur me këtë dhe na tha se nesër do të vij në zyrën e juaj edhe do të sqarohemi. Të nesërmen unë nuk e kam pa, në zyrën time nuk ka qenë. Pas kalimit të afatit 7 ditor sistemi në mënyrë automatike e ka bërë korigjimin e regjistrave kadastral. Paraprakisht ne kemi qenë edhe në agjensionin kadastral dhe jemi konsultuar se si t'ia bëjmë me këtë dhe atë para se të bëhet korigjimi i regjistrimit, në agjensionin kadastral ka qenë kryeshefi që na e propozoj dy zyrtarë ligjor me të cilët u konsultuam lidhur me rastin në fjalë, edhe ata na propozuan që duhet ta korigjoni dhe vendimi duhet të jetë koligjial, dhe në ndërkohë është bërë korigjimi më vonë kemi kërkuar edhe interpretim ligjor nga agjensioni kadastral të cilët edhe na janë përgjigjur me shkrim dhe atë me nr.03/1773/14 të dt.02.11.2015. gjendja që nga viti 1985 është e

ndërtuar ferma e dhive. Sa i përket kësaj çështje penale askush nuk ka përfituar por të dëmtuar ne jemi që vimë në gjykatë për këtë çështje penale.

Po është e vërtetë se unë aktvendimin me nr.248/14 të dt. 02.05. 2014, e kam nënshkruar, dhe nuk më kujtohet se a e kam lexuar përmbajtjen e këtij aktvendimi. Me fjalën ndryshim ose ndërrim nënkuptoj ndryshimin e titullarit mbi pronën e pa lujtshme duke u bazuar në ndonjë bazë juridike dhe mënyra e regjistrimit është në kadastër do me thënë pronar i palujtshmërisë nuk mund të bëhet pronar pa e regjistruar në kadastër. Ndërsa me fjalën korigjim nënkuptoj një gjendje që ka ekzistuar më parë por pa ndonjë bazë apo pa ndonjë arsye juridike është bërë ndryshimi apo gabimi dhe të cilin organi që vet e ka nxjerë mund ta korigjoj në çdo kohë. Po kemi vepruar drejtë meqë ne nuk e kemi ndërruar titullarin ne vetëm e kemi bërë korigjimin e regjistrimit i cili edhe ka qenë në gjendjen e tanishme mirëpo për arsye të gabimeve teknike ka mundur të jetë më ndryshe. Thash edhe më herë se me shkrim e kemi njoftuar Laz Ballabanin, mirëpo fletkthesën a e ka pranuar këtë njoftim këtë nuk e kemi. Të njejtit nuk ia ka kufizuar e drejta ngase ai ka qenë i njohur gojarisht që ndryshimi do të kryhet. Pala duhet gjithmonë të komunikohet në formë të shkruar, çka që edhe këtë rast kështu kemi vepruar. Sipas këtij aktvendimi Lazi ka patur afatin 30 ditor që të parashtron ankesë para organit në fjalë, mirëpo i njejtë nuk e ka bërë të njejtën, mirëpo unë nuk jam kompetent që ta përcjelli fletkthesën se a është kthyer apo jo, e ne pyetjen e prokurorit se a mundeni të na sqaroni përkitazi me këto ndryshime për palujtshmërinë në fjalë duke qenë se sipas listës poseduese nr.18 të dt.19,08,2003, parcela nr.1589 figuron në emër të, sipas listës poseduese nr.260 të dt.15.08.2007, kjo parcelë figuron në emër të Agromoravës, ndërkaq sipas listës poseduese nr.18 të dt.14.08.2014, kjo parcelë figuron në emër të Nue Ballabanit, i njejtë pergjigjet juridikisht gjendja në kadastër deri në vitin 2007, ka qenë në emër të Nue Ballabanit, do të thotë deri sa është nxjerrë aktvendimi me nr.248/2014. Më dt. 15.08.2007, e vërtetë është që është në emër të Agromoravës, do të thotë se në emër të Agromoravës ka kaluar një ditë pasi që është nxjerrë aktvendimi në vitin 2007. Lista poseduese është e dt. 14.08.2014, përpara ndryshimet nëpër zyret kadastrale janë përcjellë në agjensionin kadastral në mënyrë fizike kanë ardhë në periudha të caktuara dhe i kanë marrë ndryshimet. Në këtë vit 2007, është edhe ndërrimi i dy sistemeve kalimi prej KCID në RDPP, dhe kur i kanë marrë ata shënimet i kanë

marrë zakonisht në periudhat 3 mujore ose 4 mujore në ndërkohë sistemi i KCID na është ndërpre që në këtë sistem të mos punohet, dhe kemi filluar në sistemin e RDPP, meqë nevojat e mëdha dastrale për përcjelljen e ndryshimeve kemi kërkuar nga agjensioni kadastral të na i kthejë së paku si arhivë KCID-in, edhe këtu ata e kanë kthyer gjendjen sikur e kanë marrë para 3-4 muajve, vetëm për me pa ne si arhivë, edhe gjatë kësaj forme është bërë ndryshimi që është kthyer në gjendjen e më parshme të Nue Ballabanit, dhe fleta poseduese natyrisht është lëshuar në emër të me të cilën fletë poseduese i njeiti me qëllim ose pa qëllim e ka bërë tjetërsimin e pronës nga babai i vet në emër të Laz Ballabanit, me kontratë falje. Unë T. N nuk ia kam shpjeguar përmbajtjen e këtij aktvendimi meqë me të njejtin kemi qenë bashkë në agjensionin kadastral dhe e ka ditur rastin. Harrova të cekim edhe këtë se zyra kadastrale në Kosovë punojnë me kompetenca të deleguara neni 5 të ligjit mbi kadastrë që do të thotë për ne këta janë shkallë e dytë që i kontrollojnë punët tona.

Korigjimi ka qenë vetëm në lidhje me këtë ngastër 1589. Unë jam i njohur se ekziston insituti i kthimit në gjendjen e më parshme dhe insituti i përsëritjes së procedurës. Sikur mos ta kishim bërë këtë korigjim ne do të ishim prap në ulësën e të akuzuarve, nga pala tjetër e cila e ka blerë ndoshta së bashku me AKM-ën si ndërhyrës. Me përgjegjësi morale dhe penale deklaroj se sa i përket këtij rasti nuk kam patur kurfarë përfitimi por vetëm që më është shkaktuar dëm.

Neve si organ i dytë na përcjell Agjensioni kadastral i Kosovës, tani punojmë në sistem të gjitha ndryshimet që sot bëhen në zyrën kadastrale automatikisht janë përcjellur në agjensionin kadastral dhe të nesërmen shihen në ekranin e madh në koridor të agjensionit. Nuk ka ndodhë që ne mos të korigjojmë gabimet teknike që bëhen në zyrën kadastrale. Korigjime të tilla mund të ju jap 100 shembuj vetëm brenda këtij viti, edhe atë ndërrime të titullarëve ku toka ka dalë nga Letnica në Pejë, Prizren etj. Nuk kemi pasur vërejtje asnjëherë as unë e as kolegët e mi nga ana e organit ku punojmë, përkundrazi ne për punën që kemi kryer jemi të shpërblyer.

Ky ka qenë gabim i sistemit të na në kadastrë edhe e kemi korigjuar ne vet regjistrin. Së pari duhet të shterren procedurat administrative. Për rastet e tilla

ne kemi edhe prej agjensionit kadastral njoftimin që kemi të drejtë ti korigjojmë gabimet teknike.

I akuzuari T. N si gjatë fazës së hetimeve edhe në shqyrtimin gjyqësorë deklaron: Që nga 15 janari i vitit 2014, deri më dt. 03.03.2015, kam qenë ushtrues detyre i Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër pronë dhe gjeodezi në K. të Vitisë, nga data 03.03.2015, jam kthyer në pozitën që e kam pasur më herët si gjeodet në kuadër të drejtorisë për kadastër pronë dhe gjeodezi. Në maj të vitit 2014, kam qenë ushtrues detyre, gjatë periudhës sa kam qenë ushtrues detyre kujtoj muaji prill, saktësisht nuk mundem me ditë për parcelën 1589 z.k. Stubëll e Epërme, është bërë krigjimi kadastral. Aktvendimin për korigjim e ka pregaditur zyrtarja juridike duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi. Gjatë periudhës sa kam qenë ushtrues detyre asnjëherë nuk i kam sjellur dobi as vetet e as palëve tjera, mirëpo në këtë rast konkret ne vetëm jemi të dëmtuar. Unë vetëm e di se sistemi KCID sipas kolegëve që kanë punuar aty më herët ka filluar diku pas luftës deri në vitin 2007, e pas vitit 2007 deri ka mesi i vitit 2013, kanë punuar sipas sistemit RDPP, e që nga viti 2013 e tani është KCLIS, parcela e cila është objekt akuze është e ndërtuar ferma e dhive saktësisht në parcelën e lartë shënuar është ndërtuar objekt i fortë duke përfshirë edhe bllokun e parcelave që besoj janë 12 parcela. Në bazë të dhënave unë kam filluar punën si gjeodet në 04.02.2012, dhe në bazë historiatit që e kemi bërë për parcelën në fjalë fillimisht për të cilën është shpallur vendimi , është shpallur vendimi për interes të përgjithshëm për parcelën e lartë shënuar nga Kuvendi Komunal. Pastaj ekziston një shkëputje e dokumentacionit të cilët i ka marrë sistemi serb prej zyreve kadastrale dhe shkëputjetë të cilat janë bërë gjatë tërë asaj periudhe ne nuk kemi kurfarë dokumentacioni. Pastaj sipas kolegëve Drejtoria për kadastër ka punuar me shenime të vitit 1982 deri në vitin 1984, këtu është ndërpre që nga viti 1998 - 1999 e brenda kësaj periudhe mungojnë shenimet, në mungesë të këtyre shenimeve të dhënat e gjendjes së fundit të vitit 1983- 1985 , me këto të dhëna agjensia kadastrale e Kosovës i ka futur në sistemin zyrtarë dhe parcela në fjalë dhe duke i përfshirë edhe parcelat tjera janë rikthyer edhe nëse ka pasur ndryshime, tek pronarët e më parshëm. Agjensia Kosovare e privatizimit atëherë ish AKM i drejtohet me kërkesë Drejtorisë për kadastër që parcela në të cilën është ndërtuar ferma e dhive përfshirë këtu edhe parcelën numër 1589 ti rikthejë në pronësi të ndërmarjes shoqërore "Agromorava" në Viti, duke u mbështetur në vendimin e Kuvendit Komunal të vitit 1985. Drejtoria e jonë ka pregaditur – lëshuar aktvendimin nr.214/07, aktvendim me të cilën i njihet e drejta e pronësisë Ndërmarjes Agromorava, duke përfshirë parcelën me nr.1589 dhe tërë bllokun e parcelave ku është ndërtuar ferma e dhive. Gjithmonë sipas shenimeve apo regjistrave

zyrtarë të cilët i posedon drejtoria e jonë. Në vitin 2009, AKM-ja përmes ankandit publik e ka shitur tek, pastaj sipas kolegëve pronari i cili i ka blerë parcelat në fjalë për shkak të mungesës të tatimit në pronë nuk ka mundur ti regjistroj në Drejtori për kadastër. Gjatë kësaj periudhe është ndodhur ky gabim teknik saktësisht diku në maj të vitit 2013, kur unë nuk kam qenë ushtrues detyre aty dhe gabimin e njejtë ne e kemi vërejtur vetëm përafërsisht pas një viti pas rikërkesës së për regjistrim të parcelave. Në këtë rast zyrtarja juridike pasi e ka kompletuar dosjen e ka has në gabimin që është bërë para një viti, ka marrë të gjitha veprimet ligjore të cilat janë detyruara me ligjin për kadastër dhe ligjet tjera të cilat kanë qenë të involvuara në këtë rast.

Unë si ushtrues detyre në këtë drejtori, gjatë kësaj kohe kam nënshkruar përafërsisht 1200-1500 vendime, dhe të njejtat për një kontrollë si ushtrues detyre nuk kam pasur mundësi ti këntrolloj në detaje. Është e vërtetë se e kam nënshkruar vendimin nr. 248/14, mirëpo në detaje përbajtjen e të njejtës nuk e kam lexuar. Me fjalën korigjim nënkuptoj profesionalisht si ekspert i gjeodezisë, kur të bëhet ndonjë korigjim në regjistrat kadastral, ndonjë gabim të cilat ndodhin, kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin dhe të na përcjellin çdo ditë, duke përfshirë këtu pronarët, numrin e parcelave, sipërfaqja etj.

Ndërsa me fjalën ndryshim nënkuptoj – e përmenda edhe më herët që me profesion jam gjeodet dhe terminologjin juridike nuk e njoh mirë. Nëse i referohemi rastit konkret mendoj që bëhet edhe ndërrimi i titullarit me korigjim duke u bazuar në aktvendimin 214/07, në këtë rast ne kemi bërë korigjim në regjistrat kadastral përfshirë këtu edhe pronarin e parcelës. Si për shembull parcela ka numër unik, pronar dhe sipërfaqe krejt këtë me lidhë që mundësitë për gabime janë te këto tri raste. Unë e përmenda më herët që në bazë të të dhënave zyrtare gabimi është bërë diku në maj të vitit 2013, të cilin gabim e kemi korigjuar në vitin 2014. Nga viti 2007, deri në vitin 2013, parcela e lartë shenuar ka qenë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore “Agromorava”, pastaj gabimi që është bërë në vitin 2013 e i cili është përmirësuar në vitin 2014, kjo është arsyeja të cilën e ka nxjerrë listën poseduese në emër të vet. Kjo është arsyeja pse në fletën poseduese është edhe parcela me nr.1589, z.k. Stubëll e Epërme. Thash më herët që si ushtrues detyre nuk jam marrë me çështje teknike por sipas zyrtarëve të njejtën ia kam përcjellë zyrës së arhivës. Nuk e di se Laz Ballabani a e ka pranuar këtë aktvendim. Unë kam qenë udhëheqës i drejtorisë

në fjalë të dëmtuarit asnjëherë nuk kanë qenë as në zyrën time dhe as që kam parë ndonjë ankesë nga të njëjtit lidhur me parcelën në fjalë. Deri sa kam qenë unë ushtrues detyre nuk ka bërë kurfarë ankesë lidhur me aktvendimin në fjalë. Unë nuk mund ta di se a mund të bëhet ndryshimi pa u bërë aktvendimi i plotfuqishëm për arsye se këto nuk janë punë, detyra profesionale me të cilat merrem unë.

Me provat e shtjelluara në shqyrtimin gjyqësorë dhe vlerësimin e tyre veç e veç, trupi gjykues të akuzuarit i liroi nga akuza, meqë nuk u provua se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Këtë gjendje faktike të kësaj çështje penale, trupi gjykues e vërtetoi nga mbrojtja e të akuzuarve, dëshmia e dëshmitarëve, pjesërisht nga dëshmia e dëshmitarit, nga leximi i deklaratës së dëshmitares E. K të dhënë në prokurori më dt. 02.02.2015, aktvendimi me nr.248/14 e dt. 02.05.2014, njoftimi nr.07/07521 i dt.14.04.2014, e lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë në Viti, vendimi mbi eksproprijimin e dt. 01.02.1985, vendimi mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm me nr. të rastit 011/50, të dt.12.04.1985, e shpallur në gazetën zyrtare të KSAK nr.17 të dt.24.05.1985, certifikata mbi pronën me nr.3434/14 i dt.11.08.2014, aktvendimi me nr.214 i dt.14.08.2007, lëshuar nga zyra kadastrale K. Viti, përgjigja në kërkesën me nr.3933/14 e dt.29.09.2014, përgjigja në kërkesë 03/1773/14 e dt.06.01.2015, të lëshuara nga AKP zyra në Gjilan.

Nga aktvendimi me nr.214 të dt.14.08.2007, vërtetohet se është aprovuar kërkesa e NSH, NBIQ "Agromorava" me seli në Viti e cila ka të bëjë me bartjen dhe regjistrimin e paluejtshmërisë të parcelës kadastrale me nr.1589 ZK. Stubëll e Epërme dhe e parcelave të tjera si në aktvendimin me numër dhe datë si më lartë.

Nga vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm me nr.17 të dt.24.05.1985, vërtetohet se me qëllim të ngritjes së fermës së dhive shpallet me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale me nr.1589 (objekt akuze) dhe (e ngastrave të tjera) në pronësi private të qytetarëve në komunën kadastrare Stublla e Epërme , në dobi OP në themelimin ", - do të bëhet bartja e tokës në pronësinë shoqërore në shfrytëzim të përhershëm.

Trupi gjykues ia fali besimin edhe pjesës së dëshmisë së dëshmitarit Frok Ballabani, kur babai i tij e ka njoftuar se pronën kontestuese ia kishte uzurpuar shteti jugosllav dhe pas luftës deklaroi se nuk kanë bërë kërkesë në Komunën e Vitisë që kjo pronë t'i kompensohet.

I falet besimi edhe dëshmitarit- operatorë i ndërrimeve në sektorin e kadastrit në pjesën e deklaratës së tij se në vitin 2007 është nxjerrë një aktvendim mbi korrigjimin të cilin aktvendim e ka nxjerrë juristi (aludon në aktvendimin 2014 të dt.14.08.2007), me të cilin aktvendim mbi korrigjimin është bërë ndryshimi sipas sistemit RDPP (Regjistri i të drejtave të pronave të paluejtshme), dhe kur është bërë ndryshimi atëherë "Agromorava" e ka qitur në shitje, e i cili dëshmon se në bazë të sugjerimeve të drejtorisë – Agjensionit Kadastral të Kosovës është nxjerrë vendimi mbi lejimin e korrigjimit të tilluarit të pronës si në rastin konkret ashtu edhe i shumë rasteve të tjera për të cilat edhe janë marrë aktvendime të tilla.

Gjithashtu iu fal besimi edhe pjesës së dëshmisë së dëshmitarit Xh. Sh, operator i ndërrimeve në sektorin kadastral KK.Viti, se ndryshimet në librat e kadastrit bëhen me kërkesën e palëve dhe vendimit që lëshohet nga juristi i drejtoratit dhe korrigjimi në titullarë mund të bëhet në bazë të shënimeve që janë në aparatën kadastrale, nga e cila dëshmi vërtetohet se përveç aktvendimit të lëshuar nga DGJKP në Viti me nr.248/14 (objekt akuze) kanë nxjerrë edhe shumë aktvendime të tjera të llojit të tillë – të korrigjimit të titullarëve të pronës. Nga dëshmia e tij gjithashtu vërtetohet se disa herë kanë ushtruar kërkesë në shkallën e dytë – në Agjensionin Kadastral të Kosovës për sqarime, e nga të njëjtit disa herë kanë marrë përgjigje, citoj: "gabimet të cilat i vëreni në drejtorat dhe gabimet të cilat ndodhin mund të bëni korrigjime".

Drejtoria për Kadastër, pronë dhe Gjeodezi K.V me parashtresën 03/1773/14 të dt.22.12.2014, kërkon nga zyra ligjore e Agjensionit Kadastral të Kosovës, për të dhënë sqarimin në lidhje me regjistrimin e parcelës me nr.1589-OZK, e cila parcelë në vitin 2007, me vendimin nr.214/2007 të dt.14.08.2007, është regjistruar në emër të N.SH "Agromorava" në Viti dhe në ndërkohë është privatizuar në vitin 2009 bashkë me parcelat e tjera në të cilat është ndërtuar ferma e dhive – për të dhënë sqarime, se a mund të bëjnë korrigjimin e parcelave në bazë të ligjit mbi kadastër.

AKK – pas shqyrtimit të kërkesës, duke iu referuar aktvendimit me nr.248/14 të dt.02.05.2014, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër , pronë dhe gjeodezi K. Viti , konstaton se aktvendimi në fjalë për korrigjimin e regjistrit kadastral është nxjerrë duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjithashtu, edhe nga kërkesa e dytë e drejtorisë për kadastër pronë dhe gjeodezi 03/1773/14 të dt.20.10.2015, drejtuar Drejtoratit ligjor të AKK, që të sigurohet më gjërësisht lidhur me korrigjimin e aktvendimit me nr.248/14 të dt.02.05.2014, nga ZKK Viti, AKK –ja duke u bazuar në ligjin me nr.04/L-013 për kadastër, ligji nr.02/L-28 për procedurën administrative, udhëzimin administrativ nr.MSHP 2004/03 për zbatimin e ligjit mbi themelimin e regjistrit për të drejtat në pronën e paluajtëshme, udhëzimin administrativ nr.02/2013 për zbatimin e ligjit për kadastër, Z.KK- Viti ka nxjerrë aktvendimin korrigjues me nr.248/14 të dt.02.05.2014, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi, (përgjigja në kërkesën e AKK me nr.03/1773/14 të dt.02.11.2015).

Trupi gjykues pas analizimit me kujdes të të gjitha provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësorë ka ardhë në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë edhe mbrojtjes së të akuzuarve, të cilat e mohuan kryerjen e veprave penale për të cilat janë akuzuar, për shkak se mbrojtjet e të akuzuarve janë në harmoni në mes veti, si dhe të njëjtat gjejnë mbështetje edhe në provat materiale të cilat janë administrua gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësorë.

Trupi gjykues konsideron se të akuzuarit në rastin konkret në mënyrë të rregullt kanë kryer detyrat e punës të cilat iu janë besuar sipas pozitës dhe autoriteteve zyrtare, dhe sipas sugjerimeve të dhëna nga ana e Agjensionit Kadastral të Kosovës – zyra ligjore me numër dhe data si më lartë, që të bëjnë korrigjimin në shënimet e librave kadastrale sipas vendimit për ndërrimin e titullarëve të paluejtshmërive, ku gjindet edhe paluejtshmëria kontestuese të vitit 2007, e cila ishte e mbështetur në vendimin mbi eksproprijimin 011-50 të dt.12.04.1985, e shpallur në gazetën zyrtare të KSAK me nr.17 të dt.24.05.1985, bashkangjitur shkresave të lëndës, do të thotë se të akuzuarit nuk kanë marrë aktvendim për ndërrimin e titullarit të paluejtshmërisë kontestuese meqë i njejtë është marrë në vitin 2007 nga zyrtari ligjor i DGJKPS, por kanë marrë vendimin nr.248/14 në të cilin është bërë vetëm korrigjimi i regjistrit kadastral i

titullarit të pronës me nr.1589-0, e cila gjindet në zonën kadastrale në , nga ish pronari” nga V

Për trupin gjykues ka qenë kontestuese fakti se a iu kanë shmangur procedurave ligjore, të akuzuarit me qëllim të përvetësimit të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, apo shkaktimin e dëmit personit tjetër, dhe a mund të konkludohet se në veprimet e tyre përmbushen elementet e veprës penale të shpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 të KPRK-ës, për të cilat vepra edhe janë akuzuar të akuzuarit.

Duke patur parasysh elementet e kësaj vepre penale që duhet të përmbahen për ekzistimin e kësaj vepre penale, trupi gjykues konsideron se aktvendimin nr.248/2014 të lëshuar më dt.02.05.2014, nga zyra komunale kadastrale në Viti, e cila është objekt akuze të akuzuarit nuk e kanë bërë me qëllim të përvetësimit për vete apo për tjetrin, apo për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, mirëpo kanë vepruar sipas detyrave, kompetencave që kanë patur, si dhe sugjerimeve të dhëna nga Agjensioni kadastral i Kosovës.

Trupi gjykues konsideron se nuk rezulton se në veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprës penale nga neni 422 par.1 të KPRK-ës, gjegjësisht nuk rezulton se vepra penale është kryer me dashjen e të pandehurve, si element bazë i kësaj vepre penale, meqenëse kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtë për drejtë e cila përfshinë edhe dieninë e kryesit se po shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po tejkalon kompetencat e tij ose nuk po kryen detyrën e tij, si dhe faktin se me këtë përfitojnë dobi pasurore për vete apo për tjetrin ose i shkakton tjetrit çfardo dëmi. Ndërsa, nga provat e shtjelluara në shqyrtimin gjyqësorë, përshkrimi i veprimeve i të akuzuarve si persona zyrtarë me asnjë rrethanë nuk vërtetohet se të njëjtit duke keqpërdorur detyrën zyrtare, tejkaluar apo shfrytëzuar të njëjtën, me dashjen e tyre ka ndër marrë veprime konkrete për të përfituar për vete apo për të tjerët apo për ti shkaktuar në mënyrë të qëllimshme dëm dikujt. Në anën tjetër ky fakt konsiderohet element esencial i kësaj vepre penale dhe pa ekzistimin e këtij elementi, atëherë, nuk mund të ekzistojë as kjo vepër penale.

Me vlerësimin e provave të shtjelluara në shqyrtimin gjyqësorë mbrojtës së të akuzuarve, deklaratave të dëshmitarëve, si dhe provave materiale, gjykata

konsideron se në rastin konkret nuk u provua se të akuzuarit kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK –së, për të vërtetuar faktin se të njejtit kanë kryer veprën penale në fjalë.

Nga kjo që u tha më lartë trupi gjykues nxjerr përfundim dhe konsideron se në mungesë të provave të akuzuarit H. A, F. H dhe T. N, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-ës, lirohen nga akuza.

Sipas kërkesës së gjykatës, dërguar Agjensisë Shtetërore të Arkivit të Kosovës, lidhur me kompensimin për eksproprijimin e ngastrës kadastrale me nr.1589, në vendin e quajtur “Gjakovac reka” ish pronarë nga fsh.Stubëll e Epërme K.Viti është marrë përgjigja se Departamenti i veprimtarisë arkivore të Kosovës nuk posedon Fondin e Komunës së Vitisë – nuk posedojnë materiale arkivore të K. të Vitisë.

I dëmtuari L.B.për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në dispozitën e nenit 454 par.1 të KPPK-ës .

Nga të cekurat e mësipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE
Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan
Më dt. 21.12.2016

Sekretare juridike,
Fatmire Sermaxhaj,d.v.

Kryetarja e trupit –gjyqtarja,
Emine Salihu,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa ushtrohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.

